

Drejtuar: Komisionit Universitar të zgjedhjeve në UT

Nga: Prof. dr. Dervish Alimi, prof. ordinar në Programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Fakulteti Filologjik

Lënda: Programi i punës për periudhën trevjeçare 2023-2026 për Postin e Rektorit të Universitetit në Tetovë

Bazuar në ndjenjën e obligimit për dhënien e kontributit personal profesional dhe akademik në rrjedhat shoqërore në fushën e arsimit të lartë dhe për përmirësimin dhe ngritjen cilësore të ofertës akademike,

Kam nderin dhe kënaqësinë, t’jua parashtroj kandidaturën time dhe Programin tim të punës për drejtimin e Universitetit të Tetovës për periudhën e ardhshme trevjeçare, bazuar në:

- Kualifikimet e mia shkencore dhe sidomos thirrjen e nevojshme mësimore-shkencore të **Profesorit ordinar** që është kushti kryesor dhe prioritar ligjor për bartjen e këtij funksioni,
- **Parimin e senioritetit** në karrierë, që është parakusht vendimtar për rrezatimin e seriozitetit në punë dhe të autoritetit në vendimmarrje, bazuar në përvojën time gati 20 vjeçare akademike në universitet, (dhe 10 të tjera në arsimin paraprak), të përqëndruar në sferën e ligjërimit edhe të hulumtimit shkencor, etc.
- përgatitjen time profesionale në njohjen e më shumë se 10 gjuhëve të huaja që mund të shërbejë shumë në ushtrimin e kompetencave kryesore ligjore për përfaqësimin e UT në kontakte dhe takime me përfaqësues të universiteve tjera jashtë vendit, pa pasur nevojën e përkthyesit, sidomos në kohërat moderne ku njohja e gjuhëve moderne është bërë *conditio sine qua non*, dhe dëshmi e pashmangshme e përgatitjes solide profesionale dhe e integritetit akademik të bartësve të posteve kryesore në institucionet e arsimit të lartë dhe jo vetëm,
- përgatitjen time profesionale si jurist i diplomuar, d.m.th. si njohës solid i obligimeve dhe procedurave ligjore, e nevojshme sidomos në raste immediate të vendimmarrjes, pa pasur nevojën e konsultimit të vazhdueshëm të këshilltarit juridik në ushtrimin e kompetencave ligjore të parashikuara me ligjin për arsimin e lartë. Këtë edhe e kam dëshmuar në rastet e pjesëmarrjes në komisione disiplinore pranë fakultetit dhe universitetit, dhe njëkohësisht kam dhënë shembull konkret me merita individuale për avancimin e lirisë akademike brenda universitetit,

- përvojën time menaxhuese të fituar gjatë kohës së ushtrimit të postit të Shefit të programit studimor të Gjuhës dhe letësisë angleze në periudhën fillestare të legalizimit të UT, të shoqëruar me qasje korrekte si ndaj kolegëve ashtu dhe studentëve dhe stafit administrative.

Andaj, duke pasur parasysh se Universiteti ynë ka nevojë për përditësim dhe përshtatje profesionale me ecuritë moderne të ofertës dhe kërkesës së tregut të punës gjegjësisht të studimeve universitare, jo vetëm nëpërmjet të mësimdhënies dhe kryerjes së obligimeve pedagogjike, por edhe avancimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të stafit akademik, si dhe këmbimit më të shpeshtë studentor me universitete tjera simotra, dhe

Duke dashur ta ofroj veten për realizimin e ndryshimeve të nevojshme kadrovike në drejtimin e Universitetit,

Më lejoni t’jua prezentoj vizionin tim për udhëheqjen e institucionit tonë, të cilin për shkaqe praktike, e parashtroj si vijon:

1. Si Rektor i UT, në bashkëpunim të ngushtë me pro-rektorët dhe së bashku me dekanët e Fakulteteve, do të ushtroj me përkushtim kompetencat ligjore për menaxhimin dhe koordinimin e punës me theks të veçantë në Sektorin për Arsim dhe Shkencë dhe për afirmimin e mëtejshëm të universitetit, me Sektorin për Marrëdhënie me Jashtë. Një qasje e këtillë bashkëpunimi do ta përparonte edhe më tej universitetin tonë brenda kornizave që parashikon “Carta Magna“ e Bolonjës, dhe programeve të tjera simotra të tipit Erasmus Plus dhe të ngjashme, gjë që do t’i mundësonte universitetit tonë një rangim më të lartë nga ana e skemave akademike të vlerësimit, si ajo e Shanghait dhe të tjera.

Pikësynimi ynë kryesor do të jetë të arrijmë të rangohemi ndër pesë universitetet e para në vend dhe si rezultat të fitojmë edhe të drejtën e organizimit të studimeve të doktoraturës, aq më tepër kur sot edhe i plotësojmë kushtet e nevojshme ligjore të titullarëve të profesorëve ordinarë.

2. Ndërmarrja e nismave të reja, në drejtim të riorganizimit të brendshëm të Universitetit nëpërmjet të ndarjes plotësuese të detyrave dhe të përafrimit të shërbimeve të reja akademike, me qëllim përshtatjen tonë me nevojat e tregut ekonomik dhe shkencor, si psh. në rrafshin e:

- a. **Krijimit të Qendrave dhe Instituteve përkatëse brenda çdo fakulteti**, në suaza të kompetencave që burojnë nga autonomia universitare dhe e drejta jone statutare. Kjo do ta përfshinte gjithë stafin e brendshëm akademik në dhënie e kontributit për avancimin e kërkimtarisë shkencore, por dhe në ofrimin e trajnimit apo specializimit të kuadrove të jashtëm, që do të donin të fitonin licenca për punë të specializuar në sferën e tregut të lirë

intelektual, p.sh. në sferën e mjekësisë, në fakultetet poli-teknike, të bujqësisë, etj. Kjo pastaj do të sillte burime të jashtme fitimprurëse për fakultetet tona, që do të investoheshin jo vetëm për mbulimim shtesë të harxhimeve materiale por edhe të shtesave motivuese të pagave për burimet njerëzore pjesëmarrëse në këto aktivitete plotësuese. Kuptohet se nuk do të mungojë aspak angazhimi ynë për sigurimin e lejeve të nevojshme nga organet kompetente apo të sigurimit të kornizës ligjore për lëshimin e licencave dhe çertifikatave të tilla, në përputhje me parimin e përgjithshëm të drejtësisë, se çdo gjë që nuk është e ndaluar është e lejuar!

Më anë të krijimit të Instituteve të kërkimeve shkencore brenda fakulteteve përkatëse, si p.sh. Instituteve të shkencave natyrore veç e veç apo së bashku do të krijohej hapësirë për nevojën e angazhimit plotësues të kolegëve të interesuar për kërkime shkencore, por edhe burime plotësuese financiare për stafin e angazhuar në këto aktivitete shtesë. Kësisoj, në Fakultetin filologjik do të krijonim Institutin e gjuhëve vendore (zyrtare) dhe të huaja, ku do të kishim të drejtën e lëshimit të Çertifikatave ndërkombëtare për njohjen e gjuhëve të huaja të tipit TOEFL apo të *Goete institutit* dhe të ngjashme, qoftë edhe me zgjerimin e kompetencave të *Qendrës ekzistente për gjuhë të huaja*, pasi që Ne si universitet, disponojmë tashmë me kuadër të bollshëm me thirrje më të larta akademike dhe shkencore, në mënyrë që si rrjedhojë të sigurojmë mjete shtesë për mbulimin e harxhimeve rrjedhëse dhe shtimin e resurseve financiare dhe njerëzore.

Në këtë drejtim do të përpiqemi ta zbatojmë në praktikë të drejtën tonë statutare për themelimin e Qendrës Klinike Universitare gjegjësisht ta shndërrojmë Spitalin Klinik në Tetovë në Qendër Klinike Universitare, kuptohet ne koordinim me Ministrinë e shëndetësisë dhe faktorin politik në përgjithësi, por edhe me themelimin e Instituteve nga fusha e mjekësisë, ngjashëm me Institutet ekzistente brenda Universitetit Shën Qirili dhe Metodi ne Shkup, apo edhe si institute të veçanta apo te pavarura, duke ushtruar presionin publik intelektual mbi faktorin politik që të merr përsipër të sigurojë kornizë ligjore dhe mjete financiare për themelimin dhe funksionimin e instituteve të tilla, si nevojë imediate për avancimin e kërkimeve shkencore në rajonin e vendbanimeve me shumicë shqiptare.

- b. Me anë të krijimit të **Programeve të dyfishta studimore pranë Fakulteteve përkatëse** që do të propozoheshin si ofertë e re në procesin e ardhshëm të riakreditimit të programeve studimore, si psh. në Fakultetin Juridik, do të kishim si ofertë program të dytë studimor interdisciplinar apo të përzier me drejtime nga fusha e ekonomisë, si psh. Business Law-yer (=Jurist afarist) me afat trevjeçar, ku në 2 vitet e para lëndët e sferës juridike

do të ishin të përgjithshme dhe të përbashkëta, ndërsa në vitin e 3 do të ishin lëndët e specializuara të fushës ekonomike apo afariste. I njëjti parim do të vlente edhe për Fakultetin Ekonomik, i cili do të ofronte program studimor të përzier psh. Legal economy (Ekonomia ligjore) në kuptimin e studimit të funksionimit të ligjeve në ekonominë e tregut, ku do të hynin e drejta e patentës apo industriale, e konkurrencës së lirë, e autorësise, e bursës, etj.

Pastaj, në Fakultetin Filologjik, Programi studimor **Gjuhë dhe letërsi Shqipe** do të kishte kohëzgjatje katërvjeçare, ndërsa programi i dytë **Gjuhë dhe letërsi maqedonase** do të ishte me kohëzgjatje trevjeçare dhe anasjelltas, për t'ua mundësuar studentëve të diplomuar në gjuhën shqipe apo maqedone që t'i japin si provime shtesë vetëm provimet strikt profesionale të gjuhës tjetër dhe duke ua pranuar paraprakisht dhe me automatizëm kreditë tashmë të fituara nga lëndët e përgjithshme dhe joprofesionale në programin e parë, dhe anasjelltas.

Një projekt i tillë do të tërhiqte më shumë maturantë për përzgjedhjen e fakulteteve tona, pasi që ata do të pajiseshin me 2 (dy) diploma për mbarim të studimeve në ciklin e parë, valide për dy gjuhë te veçanta gjegjësisht 2 programe studimore të përfunduara në një afat të shkurtuar kohor, çka do t'u mundësonte atyre një perspektivë apo karrierë më premtuese punësimi si përkthyes apo punëtorë zyrtarë në intitucionet dhe administratën e shtetit.

E njëjta ofertë do të ishte me bashkimin e dy programeve studimore apo gjuhëve që i takojnë nje trunq apo familje gjuhësore, si psh. **Gjuha angleze me Gjuhën gjermane**, që i përkasin familjes së gjuhëve *gjermanike*, pastaj **Gjuha dhe letërsia frënge dhe italiane** që i përkasin familjes së gjuhëve *romane*, etj.

- c. Nje model i tille i **Ofertës së dyfishte do të pasqyrohej edhe në studimet e ciklit të 2-të**, ku do të mund të ofronim studime Master në kohëzgjatje 1 ose 2 vjeçare varësisht si do të ishin përfunduar studimet paraprake, siç ndodhi tashmë në akreditimin e fundit për Fakultetin filologjik, falë insistimit tone persisten indivual dhe kolegjal. Ideja është që studentët të kenë 2-dy opsione apo alternativa rezervë punësimi në treg me studime të përqëndruara apo integruara.

3. **Nëpërmjet Motivimit material për pjesëmarrje sa më të madhe nëpër konferenca shkencore ndërkombëtare** brenda dhe jashtë vendit, në kuptimin e lirimit tonë nga harxhimet personale në konferencat ku jemi nikoqirë dhe organizues, si dhe të mbulimit dhe rimbursimit të harxhimeve të udhëtimit dhe qëndrimit nëpër konferenca ndërkombëtare jashtë vendit, pa sigurimin paraprak të pëlqimit nga komision i posaçëm.

Ky parim do të vlente edhe për kompensimin nga arka e universitetit e të gjitha punimeve të botuara në revista ndërkombëtare dhe për botimin e librave shkencorë, për cilësinë e të cilave Ne mbajmë përgjegjësi personale, dhe për të cilat e kemi të drejtën tonë diskrecionale që buron nga kualifikimi dhe titulli ynë akademik dhe shkencor.

Bazuar në programin tim ambicioz dhe në përvojën time paraprake, mbetem me shpresë se do të gjej mbështetjen e stafit akademik për realizimim e objektivave të lartpërmendura, të cilat fundja janë në interes të përgjithshëm, dhe jo strikt në interes të vetpërmbushjes apo të karrierës personale.

Prandaj uroj që zgjedhja juaj të burojë nga zemra dhe zëri i ndërgjegjes personale, pa ndikime anësore politike apo preferenciale, sepse besoj se zgjedhja duhet të vijë nga bindja personale dhe si intelektualë nuk duhet të lejojmë që të tjerë të vendosin për ne dhe zgjedhjen e tyre të na servojnë në formën e aktit të kryer.

Me respekt dhe përshëndetje kolegiale,

Prof. Dr. Dervish Alimi,
Prof. ordinar

Në Tetovë, më dt 07.06.2023

/=Prof. dr. Dervish Alimi, rr. Cvetko Jakovleski, n. 14, 6250 Kerçovë,
n. tel. 070-332-302, e-mail: dervish.alimi@unite.edu.mk/